



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

# FLETINFORMACION

## PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes

KSC-BC-2020-05/KSC-CA-2023-02/KSC-SC-2024-02

Prokurori i Specializuar kundër:



Salih Mustafës

Faza e çështjes:

GJYKATA SUPREME (MBROJTJA E LIGJSHMËRISË)

# AKUZUARI/AKUZAT

**Salih Mustafa**

**Datëlindja:** 01/01/1972

**Funksionet gjatë periudhës së mbuluar prej aktakuzës:**

- Komandant i njësitit gueril BIA i cili operonte brenda Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Sipas aktakuzës, BIA kishte bazën në kompleksin Zllash, në regjionin Gollak të Kosovës, i cili ishte përdorur nga BIA si vendstrehim i sigurt dhe si qendër ndalimi dhe marrjeje në pyetje.

## Përshkrimi i akuzave

Kjo çështje ka të bëjë me aktet e Salih Mustafës në kompleksin Zllash, Kosovë, afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe rreth fundit të prillit 1999.

Sipas aktakuzës, gjatë kësaj periudhe Salih Mustafa dhe disa ushtarë, policë e roja të UÇK-së paten të njëjtin qëllim të përbashkët të marrjes në pyetje dhe keqtrajtimeve të ndaluarve në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe qëllimi i përbashkët përfshinte krimet e specifikuar si në anën e djathtë

## Format e përgjegjesisë

Ndërmarrje kriminale e përbashkët  
Kryerje e drejtpërdrejtë  
Urdhërim  
Nxitje  
Ndihmë dhe inkurajim  
Përgjegjësi penale si epror

## Akuzat

1. Ndalim arbitrar (krime lufte)
2. Trajtim mizor (krime lufte)
3. Torturë (krime lufte)
4. Vrasje e paligjshme (krime lufte)

# DËNIMET/ZHDËMTIMET

## Aktgjykimi i Trupit Gjyqes, 16 dhjetor 2022

Trupi Gjyqes e shpalli Salih Mustafën fajtor për krimet e luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme (1,3 dhe 4) ndërsa e shpali të pafajshëm për krimin e trajtimit mizor (pika 2).

Sa i përket formave specifike të përgjegjesisë, Mustafa u shpall fajtor për:  
- kryerjen e drejtpërdrejtë të krimin të torturës (pika 3)  
- krimin e ndalimit arbitrar (pika 1), torturës (pika 3) dhe vrasjes së paligjshme (pika 4), të kryera si pjesëmarrës në ndërmarrjen kriminale të përbashkët.

**Dënimi: 26 vjet burgim**

## Urdhri për zhdëmtim, 6 prill 2023

Trupi Gjyqes urdhëroi Mustafën të paguajë një shumë të gjithsejtë prej **207.000 euro** si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të krimeve për të cilat është shpallur fajtor.

## Aktgjykimi i Apelit 14 dhjetor 2023

Paneli i Apelit Ia në fuqi verdiktet e fajësisë së Mustafës për pikat 1, 3 dhe 4 ndërsa miratoi pjesërisht kundërshtimin e Mbrojtjes lidhur me kohëzgjatjen e dënimit.

**Dënimi: 22 vjet burgim**

# KRONOLOGJIA

Mustafa u arrestua dhe u transferua në njësinë e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 24 shtator 2020. Më 28 tetor 2020 i akuzuari u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

Gjykimi filloi më 15 shtator 2021 dhe zgjati deri më 15 shtator 2022.

Aktgjykimi u shpall më 16 dhjetor 2022: Trupi Gjykues e shpalli të akuzuarin fajtor dhe e dënoi me 26 vjet burgim.

Shqiptimi i urdhrit për zhdëmtimin e viktimave u bë më 6 prill 2023. Trupi Gjykues urdhëroi Mustafën të paguajë një shumë të gjithsejtë prej 207.000 euro si kompensim për dëmin e shkaktuar ndaj viktimave të krimeve për të cilat është shpallur fajtor.

Mustafa e dorëzoi apelin kundër Aktgjykimit dhe rrjedhimisht, Kryetarja caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin. ZPS-ja nuk e ka apeluar Aktgjykimin.

Aktgjykimi i apelit u shpall më 14 dhjetor 2023: Paneli i Apelit zvogëloi dënimin nga 26 në 22 vjet burgim. Aktgjykimi nuk ndikon në urdhrin për zhdëmtim meqenëse Mustafa nuk e ka apeluar atë.

Më 14 mars 2024, Mustafa dorëzoi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në përputhje me nenin 48(6) deri (8) të Ligjit dhe rregullën 193 të Rregullores. Kërkesa është duke u shqyrtuar në Gjykatën Supreme.

# STATISTIKAT E ÇËSHTJES

Kohëzgjatja e procedurës paraprake	11 muaj dhe 22 ditë
Numri i ditëve të gjykimin në sallën e gjyqit	53
Numri i dëshmitarëve gjatë gjykimin	29 (14 ZPS, përfshirë kundërdëshminë e një dëshmitari; 15 Mbrojtja)
Numri i dëshmimeve me shkrim të dëshmitarëve	2 (ZPS)
Numri i viktimave pjesëmarrëse	8
Kohëzgjatja e gjithsejtë në Gjykatën Themelore	26 muaj dhe 22 ditë
Kohëzgjatja e çështjes në apel	10 muaj dhe 12 ditë

# TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

## GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatës Nikola Giju

## TRUPI GJYKUES I



Gjykatëse Mapi  
Feld-Folia (kryesuese)



Gjykatës Roland Dekers



Gjykatës Zhilber Biti



Gjykatës Vladimir Mikula  
(gjykatës rezervë)

## PANELI I GJYKATËS SË APELIT



Gjykatëse Mishelë Pikar  
(kryesuese)



Gjykatës Kai Ambos



Gjykatëse Nina Jorgensen

## PANELI I GJYKATËS SUPREME



Gjykatëse Ekaterina  
Trendafilova (kryesuese)



Gjykatëse Kristinë van  
den Vijngart



Gjykatës Daniel Fransen

## ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Cezari Mihalq



Silvia D'Ascoli

## MBROJTJA (PËRFAQËSUESI KRYESOR)



Xhulius von Bone

## MBROJTËSJA E VIKTIMAVE




Ani Poes

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN


Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj  
për të skanuar kodet e mëposhtme:




Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës




Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSK-së



Profili X i DSK-së



Profili Instagram i DSK-së





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN